
 <b>KOMUNA SKENDERAJ</b> ÒPSTINA SKENDERAJ Ndërmarrja Publike Lokale Lokale Javne Producersha NPL "Eko Natyra" SH.A UP "Eko Natyra" A.D.					
Data: Praniaj Dorzuar (Datum: Praniaj Dorzuar)				03 / 11 / 2025	
Ajesia Org. Org. Jedin		Skat. Klas. Klas. Kod	Nr. Pril. Pr. Pril.	Nr. Paqëve Pr. Stanica	
001		001	327125	016	



**Ndërmarrja Publike Lokale**

**NPL Eko Natyra Sh.A Skenderaj**

## RREGULLORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Skënderaj, Tetor 2025

## PËRMBAJTJA

Neni 1 .....	3
Qëllimi dhe Fushëveprimi .....	3
Neni 2 .....	3
Përkufizime .....	3
Neni 3 .....	5
Parimet e përpunimit të të dhënave personale .....	5
Neni 4 .....	6
Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale .....	6
Neni 5 .....	7
Kushtet për pëlqim .....	7
Neni 6 .....	7
Përpunimi i kategorive të veqanta të të dhënave personale .....	7
Neni 7 .....	9
Të drejtat e subjektit të të dhënave .....	9
Neni 8 .....	10
Informacioni në të dhënat personale .....	10
Neni 9 .....	11
Të drejtat e Ndërmarrjes Publike .....	11
Neni 10 .....	12
Përpunuesi i të dhënave personale .....	12
Neni 11 .....	13
Incidente / shkelje e të dhënave personale .....	13
Neni 12 .....	13
Caktimi i Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale .....	13
Neni 13 .....	14
Faturimi në zarf .....	14
Neni 14 .....	14
Transferimi i të dhënave personale të shtetet tjera dhe organizatat nderkombëtare .....	14
Neni 15 .....	15
Vëzhgimi me kamerë .....	15
Neni 16 .....	15
Regjistrimet e hyrjes dhe daljes nga ndërtesat .....	15
Neni 17 .....	15
Raportimet e mospërbushjeve .....	15
Neni 18 .....	15
Pasojat e mospërbushjes .....	15
Neni 19 .....	16
Dispozita përfundimtare .....	16

Bazuar në Ligjin Nr.06/L-082, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe në nenin 7, i Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Natyra” Sh.A, të miratuar me datë 15.01.2024 nga Komisioni Komunal i Aksionarëve të Komunës së Skënderajt të NPL “Eko Natyra”, Sh.A, Bordi i Drejtorëve me datë 31.10.2025 miraton këtë:

## RREGULLORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

### Neni 1

#### Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregullore është që të përcaktojë të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së secilit individ në raport me Ndërmarrjen Publike. Përmes kësaj Rregulloreje përcaktohen edhe përgjegjësitë e Ndërmarrjes Publike për mbikqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave të çdo individi, përfshirë klientët ekzistues dhe ata potencialë, apo çdo palë tjetër.  
Sipas Ligjit Nr.06/L-082, Ndërmarrja Publike në cilësinë e kontrolluesit duhet të sigurojë konfidencialitet e mbrojtje gjatë përpunimit të të dhënave personale.
- 1.2. Kjo Rregullore duhet të njihet dhe e njëjta të zbatohet nga të gjithë punonjësit e Ndërmarrjes Publike.

### Neni 2

#### Përkufizime

1. Terminologjia dhe përkufizimet e përdorura në këtë Rregullore do të jenë në përputhje të plotë dhe do të interpretohen sipas Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
2. **E dhënë personale** - çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik;
3. **Përpunim** - çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi;
4. **Kufizimi i përpunimit** - shënjimi i të dhënave personale të ruajtura me synim kufizimin e përpunimit të tyre në të ardhmen;

5. **Pseudonimizim** - përpunimi i të dhënave personale në një mënyrë të tillë që të dhënat personale të mos vazhdojnë t'i referohen një subjekti të caktuar të të dhënave pa përdorimin e informacionit shtesë, me kusht që ky informacion shtesë të mbahet veçmas dhe t'u nënshtrohet masave teknike dhe organizative për të garantuar që të dhënat personale të mos i referohen një personi fizik të identifikuar ose të identifikueshëm;
6. **Kontrollues i të dhënave** - çdo person fizik ose juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale;
7. **Pëlqim me shkrim i subjektit të të dhënave** – pëlqimi i dhënë sipas nënparagrafit 1.11., të paragrafit 1. të këtij neni, ku përveç kësaj, subjekti i të dhënave duhet të vë nënshkrimin ose shenjën në pëlqimin me shkrim për përpunimin e të dhënave të tij ose saj;
8. **Pëlqim gojor ose pëlqim tjetër i përshtatshëm i subjektit të të dhënave** - pëlqimi nga nën-paragrafi 1.11. i dhënë gojarisht, me anë të mjeteve të telekomunikimit ose me ndonjë mjet tjetër të përshtatshëm, përmes të cilit mund të konkludohet në mënyrë të qartë se subjekti i të dhënave e ka dhënë pëlqimin e tij ose saj;
9. **Përpunues i të dhënave** - çdo person fizik ose juridik, nga sektori publik ose privat, i cili përpunon të dhëna personale për dhe në emër të kontrolluesit të të dhënave;
10. **Marrës i të dhënave** - çdo person fizik ose juridik nga sektori publik ose privat, të cilit i zbulohen të dhënat personale, qoftë palë e tretë ose jo. Megjithatë, autoritetet publike që mund të marrin të dhëna personale në kuadrin e një hetimi të veçantë, në pajtim me legjislacionin në fuqi, nuk konsiderohen si marrës. Përpunimi i këtyre të dhënave nga autoritetet publike është në pajtim me rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave sipas qëllimeve të përpunimit;
11. **Palë e tretë** – çdo person fizik ose juridik nga sektori publik ose privat që është i ndryshëm nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi, përpunuesi dhe personat që, sipas autorizimeve të drejtpërdrejta të kontrolluesit ose përpunuesit, janë autorizuar për të përpunuar të dhëna personale;
12. **Pëlqim i subjektit të të dhënave** - shprehje e lirë e vullnetit të dhënë lirisht, specifik, të informuar dhe të qartë të dëshirave të subjektit të të dhënave nëpërmjet të cilit ai ose ajo, me një deklarament ose me një veprim të qartë pohues, shprehë pëlqimin e tij/saj për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të;
13. **Shkelje e të dhënave personale** - çdo shkelje e masave të sigurisë që sjell asgjësimin, humbjen, ndryshimin, deklarimin e paautorizuar, aksidental ose të paligjshëm, ose qasjen në të dhënat personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara ndryshe;
14. **Të dhëna gjenetike** - të dhënat personale në lidhje me karakteristikat gjenetike të trashëguara ose të përfituara të një personi fizik që jep informacion unik në lidhje me fiziologjinë ose shëndetin e atij personi fizik dhe që rezulton, veçanërisht, nga një analizë e një mostre biologjike nga personi fizik në fjalë;
15. **Të dhëna biometrike** – të gjitha të dhënat personale që rezultojnë nga përpunimi specifik që kanë të bëjnë me karakteristikat fizike, psikologjike ose të sjelljes së një personi fizik që lejon ose konfirmon identifikimin unik të atij personi fizik si dhe imazhet pamore ose të dhënat daktiloskopike, psikologjike dhe të sjelljes, që i kanë të gjithë individët, por që janë të veçanta dhe të përhershme për secilin individ, nëse në veçanti mund të përdoren për

identifikimin e një individi, siç janë: gjurmët e gishtërinjve, vijat papilare të gishtit, irida, retina, tiparet e fytyrës dhe ADN-ja;

16. **Të dhëna shëndetësore** - të dhënat personale në lidhje me shëndetin fizik ose mendor të një personi fizik, duke përfshirë dhënien e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, që tregojnë informacion në lidhje me gjendjen e tij ose të saj shëndetësore;
17. **Përpunim ndërkufitar** - përpunim i të dhënave personale që kryhet në kuadër të aktiviteteve të autoriteteve në mes të shteteve;
18. **Privatësi** – respektimi i jetës private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës së telefonisë dhe e komunikimeve të tjera, në pajtim me ligjin e zbatueshëm
19. **Të dhëna personale të ndjeshme** - të dhëna personale që zbulojnë origjinën etnike ose racore, pikëpamjet politike ose filozofike, përkatësinë fetare, anëtarësimin në sindikatë ose çdo e dhënë për gjendjen shëndetësore ose jetën seksuale, çfarëdo përfshirje në ose heqje nga evidencat penale ose të kundërvajtjeve që ruhen në pajtim me ligjin. Karakteristikat biometrike, gjithashtu, konsiderohen si të dhëna personale të ndjeshme, nëse këto të fundit mundësojnë identifikimin e një subjekti të të dhënave në lidhje me cilëndo nga rrethanat e lartpërmendura në këtë nën-paragraf;
20. **Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia)** - agjenci e pavarur, përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për qasje në dokumente publike dhe mbrojtje të të dhënave personale, me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si dhe garantimin e qasjes në dokumente publike;

### Neni 3

#### Parimet e përpunimit të të dhënave personale

1. **Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës** - të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave.
2. **Parimi i kufizimit të qëllimit** – të dhënat personale grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk mund të përpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime. Përpunimi i mëtejshëm me qëllim të arkivimit për interes publik, qëllimit të hulumtimit shkencor ose historik, ose qëllimit statistikor, nuk konsiderohet që është në mospërputhje me qëllimin fillestar.
3. **Parimi i minimizimit të të dhënave** – të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar ose përpunuar më tutje.
4. **Parimi i saktësisë** – të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara. Duhet të merret çdo hap i arsyeshëm për të garantuar që të dhënat personale që janë të pasakta, duke pasur parasysh qëllimin e përpunimit, të fshihen dhe të korrigjohen pa vonesë.

5. **Parimi i kufizimit të ruajtjes** – të dhënat personale mund të ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit, për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tutje. Me rastin e përmbyshjes së qëllimit të përpunimit, të dhënat personale asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.
6. **Parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit** – të dhënat personale përpunohen në atë mënyrë që garantojnë siguri të përshtatshme të tyre, duke përfshirë mbrojtjen ndaj përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe ndaj humbjes, asgjësimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur masa të përshtatshme teknike dhe organizative.
7. **Parimi i llogaridhënies** – kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës dhe në gjendje të zbatojë përputhshmërinë e të gjitha parimeve të përcaktuara me këtë nen.

## Neni 4

### Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale

1. Përpunimi i të dhënave personale do të realizohet nga Ndërmarrja Publike (në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale) vetëm në rastet kur është i ligjshëm, duke u zbatuar kriteret e parashikuara ligjore si:
  - 1.1. nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave të tij personale për një ose më shumë qëllime specifike;
  - 1.2. nëse përpunimi është i domosdoshëm për përmbyshjen e një kontrate, në të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese ose për të ndërmarrë veprimet lidhur me kërkesën e subjektit të të dhënave para lidhjes së kontratës;
  - 1.3. nëse përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi;
  - 1.4. nëse përpunimi është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave ose personave të tjerë fizikë;
  - 1.5. nëse përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose për ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë kontrolluesit;
  - 1.6. nëse përpunimi është i domosdoshëm për qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga kontrolluesi ose pala e tretë, përveç kur këto interesa tejkalohen nga interesat apo të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave që kërkon mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht nëse subjekti i të dhënave është fëmijë. Kjo nuk zbatohet për përpunimin e kryer nga autoritetet publike për përmbyshjen e detyrave të tyre.
2. Nëse përpunimi për një qëllim tjetër nga ai për të cilin janë mbledhur të dhëna personale nuk bazohet në pëlqimin e subjektit të të dhënave ose në legjislacionin përkatës në fuqi, me qëllim që të konstatohet nëse përpunimi për një qëllim tjetër është në pajtim me qëllimin për të cilin janë mbledhur fillimisht të dhënat personale, ndërmjet të tjerash, merr parasysh:

- 2.1 çdo lidhje ndërmjet qëllimeve, për të cilat janë mbledhur të dhënat personale dhe qëllimet e përpunimit të mëtejshëm të synuar;
- 2.2 kontekstin në të cilin janë mbledhur të dhënat personale, veçanërisht në lidhje me raportin ndërmjet subjekteve të të dhënave dhe kontrolluesit;
- 2.3 natyrën e të dhënave personale, veçanërisht nëse përpunohen kategori të veçanta të të dhënave personale, në pajtim me nenin 8 të këtij ligji ose nëse përpunohen të dhënat personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale, në pajtim me nenin 9 të këtij ligji;
- 2.4 pasojat e mundshme të përpunimit të synuar të mëtejshëm për subjektet e të dhënave;
- 2.5 ekzistencën e garancive të përshtatshme, që mund të përfshijnë enkriptimin ose anonimizimin.

## **Neni 5**

### **Kushtet për pëlqim**

1. Nëse përpunimi bazohet në pëlqim, Ndërmarrja Publike duhet të jetë në gjendje të dëshmojë, që subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij personale, si dhe nëse pëlqimi i subjektit të të dhënave jepet në formë të deklaratës me shkrim, e cila ka të bëjë edhe me çështje të tjera, kërkesa për pëlqim duhet të paraqitet në një mënyrë që është qartësisht e dallueshme nga çështjet e tjera, në një formë të kuptueshme dhe lehtësisht të qasshme, duke përdorur gjuhë të qartë dhe të thjeshtë.
2. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të tërheqë pëlqimin e tij në çdo kohë. Tërheqja e pëlqimit nuk ndikon në ligjshmërinë e përpunimit, bazuar në pëlqim para tërheqjes dhe subjekti i të dhënave njoftohet për këtë. Tërheqja duhet të bëhet në të njëjtën mënyrë si edhe vetë dhënia e pëlqimit. Gjatë vlerësimit, nëse pëlqimi është dhënë me vullnet të lirë, mbi të gjitha, duhet marrë parasysh nëse, përveç të tjerash, zbatimi i kontratës, përfshirë dispozitën e një shërbimi, kushtëzohet me pëlqimin e përpunimit të të dhënave personale që nuk është e domosdoshme për zbatimin e asaj kontrate.

## **Neni 6**

### **Përpunimi i kategorive të veçanta të të dhënave personale**

1. Në rast të realizimit të përpunimit të kategorive të veçanta të të dhënave personale, si të dhënat personale që tregojnë origjinën racore ose etnike, bindjet politike, bindjet fetare ose filozofike, anëtarësinë në bashkimet profesionale, si dhe përpunimi i të dhënave gjenetike, të dhënave biometrike për qëllimet e identifikimit të një personi fizik në mënyrë unike, të dhënat në lidhje me shëndetin ose të dhënat në lidhje me jetën seksuale ose orientimin seksual të një personi fizik është i ndaluar përveç nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e qartë për përpunimin e atyre të dhënave personale për një ose disa qëllime më specifike, përveç kur legjislacioni përkatës në fuqi përcakton që ndalimi i parashikuar nuk mund të anulohet nga subjekti i të dhënave

2. Përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve dhe ushtrimin e të drejtave specifike të kontrolluesit ose të subjektit të të dhënave në sferën e të drejtës së punësimit, sigurimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale, në masën që është i autorizuar nga legjislacioni përkatës në fuqi ose një marrëveshje kolektive që garanton të drejtat themelore dhe interesat e subjektit të të dhënave, përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër fizik,
3. Nëse subjekti i të dhënave nuk është fizikisht ose ligjërisht në gjendje të jap pëlqimin, nëse ato përpunohen për qëllime të veprimtarive legjitime dhe me garanci të duhura nga institucionet, shoqatat, asociacionet, bashkësitë fetare, sindikatat ose organizatat tjera jo fitimprurëse me qëllime politike, filozofike, fetare, ose sindikaliste, por vetëm nëse përpunimi ka të bëjë me anëtarët e tyre ose subjektet e të dhënave që janë në kontakt të rregullt me ato e në lidhje me qëllimet e tilla dhe nëse ata nuk i zbulojnë të dhënat e tilla të tjerëve pa pëlqimin me shkrim të subjektit të të dhënave,
4. Nëse subjekti i të dhënave i ka bërë ato publike pa e kufizuar përdorimin e tyre në mënyrë të dëshmuar ose të qartë, përpunimi është i nevojshëm për qëllimet e mjekësisë parandaluese ose të punës, për vlerësimin e kapacitetit të punës së punonjësit, diagnozes mjekësore, dhënien e kujdesit shëndetësor social, trajtimin, menaxhimin e sistemeve të kujdesit shëndetësor dhe social dhe shërbimet mbi bazën e legjislacionit përkatës ose në pajtim me kontratat me një profesionist shëndetësor kur ato të dhëna procesohen nga ndonjë profesionist apo nën përgjegjësinë e tij që i nënshtrohet obligimit të fshehtësisë profesionale sipas legjislacionit përkatës, rregullave të themeluara nga organet kompetente nacionale apo nga ndonjë person tjetër që po ashtu i nënshtrohet obligimit të fshehtësisë,
5. Përpunimi është i nevojshëm për shkaqe të interesit publik në sferën e shëndetit publik, si mbrojtja ndaj kërcënimeve të rënda ndërkuftare për shëndetin ose garantimin e standardeve të larta të cilësisë dhe sigurisë së kujdesit shëndetësor dhe të produkteve mjekësore ose pajisjeve medicinale, mbi bazën e legjislacionit përkatës, gjithashtu përpunimi është i nevojshëm për qëllimet e arkivimit në interes publik, të kërkimeve shkencore, historike dhe statistikore.
6. Të dhënat personale të kategorive të veçanta mund të përpunohen për qëllimet e përmendura si më sipër, kur ato të dhëna përpunohen në mënyrë proporcionale me qëllimin e kërkuar, përpunimi i tyre e respekton thelbin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave dhe bëhet në pajtim me masat specifike për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave themelore të subjektit të të dhënave siç edhe parashihet me ligj, përfshirë aty ku është e nevojshme, fshehtësitë profesionale. Në çdo rast kategoritë e veçanta të të dhënave personale, duhet të mbrohen në mënyrë të veçantë dhe të klasifikohen me qëllim të parandalimit të qasjes dhe përdorimit të paautorizuar.

## Neni 7

### Të drejtat e subjektit të të dhënave

1. Ndërmarrja Publike që është në këtë rast në cilësinë e kontrolluesit merr masat e përshtatshme për të dhënë çdo informacion sipas parashikimeve në ligj në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, që duhet t'i nënshtrohen një formati konciz, transparent, të kuptueshëm dhe lehtësisht të qasshëm, duke përdorur gjuhë të qartë dhe të pastër.
2. Informacioni jepet me shkrim ose me mjete të tjera, duke përfshirë, sipas rastit, mjete elektronike. Nëse kërkohet nga subjekti i të dhënave, informacioni mund të jepet me gojë, me kusht që identiteti i subjektit të të dhënave të provohet (dëshmohet) me mjete tjera.
3. Ndërmarrja Publike lehtëson ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave, nuk refuzon të veprojë me kërkesën e subjektit të të dhënave për ushtrimin e të drejtave të tij përveç kur Ndërmarrja demonstroi që nuk është në gjendje të identifikojë subjektin e të dhënave.
4. Ndërmarrja jep informacion mbi veprimet e ndërmarrja me kërkesë të subjektit të të dhënave pa vonesë të panevojshme dhe në çdo rast, brenda një (1) muaji nga marrja e kërkesës. Ky afat mund të zgjatet me dy (2) muaj të tjerë nëse është e nevojshme, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe numrin e kërkesave. Kontrolluesi e njofton subjektin e të dhënave për çdo zgjatje të tillë brenda një (1) muaji nga marrja e kërkesës, së bashku me shkaqet e vonesës. Kur subjekti i të dhënave bën kërkesë me mjete në format elektronik, informacioni jepet me mjete elektronike, sipas rastit përveç kur kërkohet ndryshe nga subjekti i të dhënave.
5. Nëse Ndërmarrja nuk vepron në lidhje me kërkesën për subjektin e të dhënave, kontrolluesi njofton subjektin e të dhënave pa vonesë dhe jo më vonë se një (1) muaj nga marrja e kërkesës për shkaqet e mosveprimit dhe mbi mundësinë e paraqitjes së ankesës tek Agjencia dhe paraqitjen e një mjete gjyqësor mbrojtës.
6. Informacioni i dhënë dhe çdo komunikim dhe masë e ndërmarrë jepet falas. Nëse kërkesat nga një subjekt i të dhënave duket se janë të pabazuara ose të tepërta, veçanërisht për shkak të karakterit të tyre përsëritës, Ndërmarrja mund të caktojë një tarifë të arsyeshme, duke marrë parasysh shpenzimet administrative të dhënies së informacionit ose komunikimit, ose marrjen e masës së kërkuar, ose të refuzojë të veprojë në lidhje me kërkesën, por Ndërmarrja ka barrën e demonstrimit të karakterit haptazi të pabazuar ose të tepërt të kërkesës.
7. Nëse Ndërmarrja ka dyshime të arsyeshme në lidhje me identitetin e personit fizik që bën kërkesën, mund të kërkojë dhënien e informacionit shtesë të nevojshëm për konfirmimin e identitetit të subjektit të të dhënave.

8. Informacioni, që duhet t'u jepet subjekteve të të dhënave mund të jepet i kombinuar me (simbolet) ikonat e standardizuara me qëllim që të ofrohet një vështrim i përgjithshëm i përpunimit të synuar në një mënyrë të dukshme, të kuptueshme dhe lehtësisht të lexueshme. Nëse (simbolet) ikonat ofrohen elektronikisht, ato duhet të jenë të lexueshme në mënyrë automatike.
9. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të marrë konfirmimin nga Ndërmarrja, nëse po përpunohen ose jo të dhënat që kanë të bëjnë me të dhe nëse është rasti të ketë qasje në të dhënat personale dhe informacionin që lidhet me subjektin.
10. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të përfitojë nga Ndërmarrja, pa vonesë të panevojshme, korrigjimin e të dhënave personale të pasakta në lidhje me të. Duke marrë parasysh qëllimet e përpunimit, subjekti i të dhënave ka të drejtën t'i plotësohen të dhënat personale të paplota, duke përfshirë nëpërmjet bërjes së një deklarimi shtesë.
11. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të përfitojë nga Ndërmarrja pa vonesë të panevojshme korrigjimin e të dhënave personale të pasakta në lidhje me të. Subjekti i të dhënave ka të drejtën t'i plotësohen të dhënat personale të paplota, duke përfshirë nëpërmjet bërjes së një deklarimi shtesë.
12. Subjekti i të dhënave ka të drejtën që të kërkojë nga Ndërmarrja të bëjë fshirjen e të dhënave personale në lidhje me të pa vonesë dhe Ndërmarrja ka detyrimin të fshijë të dhënat personale, pa vonesë të panevojshme, nëse zbatohet një prej shkaqeve të mëposhtme: të dhënat personale nuk janë më të nevojshme në lidhje me qëllimet, për të cilat ato janë mbledhur ose përpunuar, subjekti i të dhënave e tërheq pëlqimin mbi të cilin bazohet përpunimi, të dhënat personale janë përpunuar në mënyrë të paligjshme, të dhënat personale duhet të fshihen për të përmbushur një detyrim ligjor të cilit i nënshtrohet Ndërmarrja.
13. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të përfitoj nga Ndërmarrja kufizimin e përpunimit të të dhënave.
14. Subjekti i të dhënave ka të drejtën për të marrë të dhëna personale në lidhje me të, që ajo i ka dhënë kontrolluesit, në një format të strukturuar, të përdorur gjerësisht dhe të lexueshëm automatikisht dhe ka të drejtën për të transmetuar ato të dhëna të një kontrollues tjetër, pa pengesë nga një kontrollues, të cilit i janë dhënë të dhënat personale, nëse është teknikisht e mundur.

## **Neni 8**

### **Informacioni në të dhënat personale**

1. Informacioni që duhet të jepet nëse të dhënat personale mbledhen nga subjekti i të dhënave

2. Nëse të dhënat personale, në lidhje me një subjekt të dhënash, merren nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi, në momentin kur i merr të dhënat personale i jep subjektit të të dhënave informacionin e mëposhtëm;
  - 2.1. hollësitë e identitetit dhe kontaktit të kontrolluesit dhe sipas rastit, të përfaqësuesit të kontrolluesit;
  - 2.2. hollësitë e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, sipas rastit;
  - 2.3. qëllimin e përpunimit, për të cilin janë të destinuara të dhënat personale, si dhe bazën ligjore për përpunimin,
  - 2.4. nëse përpunimi bazohet në nenin 5 par.1, nën par.1.6 të Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, interesat legjitime të ndjekura nga kontrolluesi ose nga një palë e tretë;
  - 2.5. marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave personale, sipas rastit;
  - 2.6. sipas rastit, faktin që kontrolluesi synon të transferojë të dhëna personale te një vend i tretë ose organizatë ndërkombëtare dhe ekzistencën ose mungesën e një vendimi përshtatshmërie të Agjencisë.
3. Ndërmarrja, në momentin kur pranon të dhënat personale, i jep subjektit të të dhënave informacionin shtesë të nevojshëm për të garantuar një përpunim të drejtë dhe transparent në përputhje me afatin dhe qëllimin për të cilin ruhen të dhënat personale, ose nëse kjo nuk është e mundur, kriteret e përdorura për të përcaktuar këtë afat, fshirjen e të dhënave personale, ose kufizimin e përpunimit në lidhje me subjektin e të dhënave, ekzistencën e të drejtës për të tërhequr pëlqimin në çdo kohë, pa ndikuar në ligjshmërinë e përpunimit, bazuar në pëlqimin para tërheqjes së tij, të drejtën për të paraqitur një ankesë tek Agjencia, nëse dhënia e të dhënave personale është një kërkesë ligjore ose kontraktuale, ose një kërkesë e nevojshme për të lidhur një kontratë, si dhe nëse subjekti i të dhënave është i detyruar të jap të dhëna personale dhe për pasojat e mundshme për mosdhënien e këtyre të dhënave,
4. Nëse informacioni nuk është marrë nga subjekti i të dhënave, do të zbatohen parashikimet sipas Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## **Neni 9**

### **Të drejtat e Ndërmarrjes Publike**

1. Ndërmarrja zbaton masa të përshtatshme teknike dhe organizative, të cilat rishikohen dhe përditësohen sipas nevojës për të garantuar gatishmërinë për të demonstruar që përpunimi të kryhet në pajtim me Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në çdo rast Ndërmarrja prirret të zbatojë parimin e minimizimit të të dhënave, në një mënyrë të efektshme për të integruar garancitë e nevojshme në përpunim, me qëllim që të përmbushen kërkesat e ligjit dhe për të mbrojtur të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe garanton se në mënyrë rastësore do të përpunohen vetëm të dhënat personale që janë të nevojshme për secilin qëllim specifik të përpunimit.

## Neni 10

### Përpunuesi i të dhënave personale

1. Në rast të nevojës për përpunim të të dhënave nga një përpunues, Ndërmarrja do të bashkëpunojë dhe përdorë vetëm përpunues që ofrojnë garanci të mjaftueshme për të zbatuar masat e përshtatshme teknike dhe organizative në një mënyrë të tillë që përpunimi të përmbushë kërkesat e ligjit në fuqi dhe të garantojë mbrojtjen e të drejtave të subjektit të të dhënave. Përpunuesi nuk ka të drejtë të angazhojë një përpunues tjetër, pa autorizimin paraprak specifik ose të përgjithshëm me shkrim të Ndërmarrjes.

2. Përpunimi nga një përpunues rregullohet me një kontratë që përcakton objektin dhe kohëzgjatjen e përpunimit, natyrën dhe qëllimin e përpunimit, tipin e të dhënave personale dhe kategorive të subjekteve të të dhënave dhe detyrimet dhe të drejtat e Ndërmarrjes. Kontrata duhet të përmbajë të gjitha elementet e nevojshme dhe të përmbushë të gjitha kriteret e parashikuara në Ligjin Nr. 06/L-082, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

3. Ndërmarrja në cilësinë e Kontrolluesit dhe përpunuesi zbaton masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm për rrezikun, duke përfshirë ndër të tjera sipas rastit;

- pseudonimizimin dhe enkriptimin e të dhënave personale,
- aftësinë për të siguruar konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë, dhe qëndrueshmërinë në vazhdim të sistemeve dhe shërbimeve të përpunimit,
- aftësinë për të rivendosur disponueshmërinë dhe qasjen në të dhënat personale në kohën e duhur,
- një proces të testimit, vlerësimit të rregullt të efektivitetit të masave teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e përpunimit.

4. Ndërmarrja dhe përpunuesi ndërmarrin hapa për të garantuar që çdo person fizik që vepron nën autoritetin e Ndërmarrjes ose të përpunuesit, i cili ka qasje në të dhënat personale, nuk i përpunon ato, përveç se sipas udhëzimeve nga Ndërmarrja, përveç kur i kërkohet ta bëjë këtë nga ndonjë ligj specifik.

5. Përpunuesi i të dhënave mund të veprojë vetëm brenda kufijve të autorizimeve të Ndërmarrjes dhe nuk mund të përpunojë të dhënat personale për qëllime të tjera. Ndërmarrja duhet të mbikqyrë zbatimin e procedurave dhe masave në pajtim me ligjin në fuqi dhe Kontratën e nënshkruar duke përfshirë edhe vizitat e përkohshme në lokalet ku bëhet përpunimi i të dhënave personale.

6. Në rast të mosmarrëveshjeve ndërmjet Ndërmarrjes dhe përpunuesit të të dhënave, apo të ndërprerjes së veprimtarive, përpunuesi i të dhënave duhet menjëherë në kërkesë Ndërmarrjes t'i kthejë të gjitha të dhënat që ai ose ajo i posedon. Përpunuesit të të dhënave nuk i lejohet t'i mbajë kopjet dhe t'i përpunojë ato më tutje.

7. Sipas nevojës dhe kërkesës, Ndërmarrja në cilësinë e Kontrolluesit si dhe përpunuesit bashkëpunojnë me Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

## Neni 11

### Incidente / shkelje e të dhënave personale

1. Në rast se secili punonjës i Ndërmarrjes, dyshon se janë shkelur të dhënat personale të ndonjë subjekti duhet të informojë në formë të shkruar Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Drejtorin e Departamentit Përkatës menjëherë.

2. Në rastin e një shkeljeje të të dhënave personale, Ndërmarrja pa vonesë dhe sipas rastit, jo më vonë se shtatëdhjetë e dy (72) orë pasi të jetë informuar rreth saj, njofton Agjencinë për Informim dhe Privatësi për shkeljen e të dhënave personale, përveç kur shkelja e të dhënave personale nuk mund të rezultojë në një rrezik për të drejtat dhe liritë e personave fizik. Nëse njoftimi i Agjencisë nuk bëhet brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve, ai shoqërohet me shkaqet e vonesës. Përpunuesit njoftojnë Ndërmarrjen, pa vonesë të panevojshme pas ardhjes në dijeni të një shkeljeje të të dhënave personale. Ndërmarrja dokumenton çdo shkelje të të dhënave personale që përbëhet nga faktet në lidhje me shkeljen e të dhënave personale, efektet e saj dhe veprimi korrigjues i ndërmarrë.

3. Nëse shkelja e të dhënave personale mund të rezultojë në një rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e personave fizik, Ndërmarrja ia komunikon shkeljen e të dhënave personale subjektit të të dhënave pa vonesë. Komunikimi drejtuar subjektit të të dhënave personale përshkruan në një gjuhë të pastër dhe të qartë natyrën e shkeljes së të dhënave personale dhe përmban të paktën informacionin dhe masat e përmendura në nenin 33 të Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Komunikimi drejtuar subjektit të të dhënave, nuk kërkohet nëse përmbushet një prej kushteve të mëposhtme:

- Ndërmarrja ka zbatuar masa të përshtatshme teknike dhe organizative mbrojtëse dhe këto masa janë zbatuar për të dhënat personale të ndikuara nga shkelja e të dhënave personale, veçanërisht ato që i bëjnë të dhënat personale të pakuptueshme për çdo person që nuk është i autorizuar për t'u qasur në to, si enkriptimi,
- Ndërmarrja ka marrë masa të vazhdueshme që garantojnë se rreziku i lartë për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave nuk vazhdon të jetë i mundur për tu realizuar,
- Do të kishte të bënte me një përpjekje disproporcionale.

Në rast të tillë, në vend të kësaj, do të ketë një komunikim publik ose një masë të ngjashme, nëpërmjet të cilës subjektet e të dhënave informohen në një mënyrë njëlojë të efektshme.

## Neni 12

### Caktimi i Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

1. Ndërmarrja cakton dhe emëron një Zyrtar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që ka aftësitë dhe eksperiencën e nevojshme për këtë post. Detajet e kontaktit të zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave publikohen nga Ndërmarrja.

2. Ndërmarrja dhe përpunuesi, sipas rastit garantojnë që zyrtari për mbrojtjen e të dhënave përfshihet në mënyrën dhe kohën e duhur, në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të

dhënave personale si dhe mbështesin zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave në përmbushjen e detyrave

3. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave raporton drejtëpërdrejtë në nivelin më të lartë menaxhues të Ndërmarrjes. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave i nënshtrohet fshehtësisë ose konfidencialitetit në lidhje me përmbushjen e detyrave të tij

4. Subjektet e të dhënave mund të kontaktojnë zyrtarin për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me çështjet që i takojnë përpunimit të të dhënave të tyre personale dhe për ushtrimin e të drejtave të tyre sipas ligjit në fuqi.

## **Neni 13**

### **Faturimi në zarf**

1. Në kuadër të sigurimit të mbrojtjes së të dhënave personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës, Ndërmarrja obligohet që ofrimin e shërbimeve për qytetarët (shpërndarjen e faturave) ta realizojnë në formatin që garanton mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve nga ekspozimi dhe qasja e paautorizuar.

2. Ndërmarrja është e obliguar të sigurojë masat e duhura të sigurisë me rastin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët (shpërndarjes së faturave) dhe të vendosin masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rreziqeve të mundshme të keqpërdorimit të të dhënave personale të qytetarëve.

## **Neni 14**

### **Transferimi i të dhënave personale të shtetet tjera dhe organizatat nderkombëtare**

1. Transferimi i të dhënave personale, të cilat janë përpunuar ose ato që do të përpunohen në vende të tjera dhe tek organizatat ndërkombëtare, mund të bëhet vetëm në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi dhe në qoftë se vendi ose organizata ndërkombëtare në fjalë siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, dhe për këtë është marrë një vendim formal dhe është përfshirë në listën përkatëse të nxjerrë nga Agjencia.

2. Po ashtu, Agjencia mund të autorizojë transferimin apo publikimin e të dhënave personale në një shtet apo organizatë ndërkombëtare që nuk siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave, nëse përmbushen kriteret e parashikuara në ligjin në fuqi.

3. Ndërmarrja mund të transferojë të dhëna personale vetëm me pranimin e autorizimit nga Agjencia, pasi ka ndjekur procesin e parashikuar në ligjin në fuqi.

## **Neni 15**

### **Vëzhgimi me kamerë**

1. Nëse planifikohet vëzhgimi me kamerë duhet të vendoset njoftimi përkatës për këtë. Njoftimi duhet të jetë i dukshëm dhe të bëhet publik, të dhënat e mbledhura nga vëzhgimi me kamerë mund të përpunohen apo të shfrytëzohen, nëse është e nevojshme për të arritur qëllimet e synuara dhe nëse nuk ekzistojnë indikacione të shkeljes së interesave legjitime të subjektit të të dhënave. Këto të dhëna mund të përpunohen apo të shfrytëzohen për qëllime të tjera, vetëm nëse janë të nevojshme për të parandaluar kërcënimet ndaj shtetit dhe sigurisë publike, apo për të ndjekur penalisht krimet. Sistemi i vëzhgimit me kamerë dhe regjistrimet e vëzhgimit duhet të mbrohen në mënyrë të duhur nga qasja dhe përdorimi i paautorizuar. Regjistrimet nga vëzhgimi me kamerë mund të ruhen deri në një (1) muaj, përveç nëse nuk kërkohet ndryshe për qëllime legjitime.

## **Neni 16**

### **Regjistrimet e hyrjes dhe daljes nga ndërtesat**

1. Për arsye të garantimit të sigurisë së njerëzve dhe sigurimit të pronës, mund të kërkohet nga personat që hyjnë ose dalin nga ndërtesa e Ndërmarrjes, që t'u japin të dhënat si: emrin dhe mbiemrin, numrin personal të dokumentit të identifikimit, adresën e përhershme ose të përkohshme, datën dhe kohën si dhe arsyen për hyrje në ndërtesë. Këto të dhëna personale mund të verifikohen duke i ekzaminuar dokumentet e identifikimit. Këto të dhëna mund të ruhen deri në tri (3) vite nga dita e regjistrimit të tyre dhe pastaj duhet të fshihen ose shkatërrohen, përveç nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe.

## **Neni 17**

### **Raportimet e mospërbushjeve**

1. Në rast të mospërbushjes, apo sjelljes jo në përputhje me këtë Rregullore, duhet të kontaktohet dhe të raportohet tek mbikqyrësi i drejtëpërdrejtë si dhe Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale që Ndërmarrja ka të emëruar në çdo kohë. Ky raportim mund të bëhet në çfarëdo mënyre, si personalisht, përmes telefonit apo e-mail. Këto raste do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe me kujdesin e nevojshëm sipas parashikimeve ligjore përkatëse.

## **Neni 18**

### **Pasojat e mospërbushjes**

1. Është e detyrueshme të veprohet në pajtueshmëri me këtë Rregullore, çdo shkelje e kësaj Rregullore mund të sjelli shkelje të parashikuara në legjislacion dhe të ketë pasoja të veprave dhe

shkeljeve të fushës civile apo penale, që mund të pasohen me dëmtim të imazhit të Ndërmarrjes dhe të punonjësve.


2. Mospajtueshmëria dhe mospërbushja e parashikimeve të Rregullorës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mund të rezultojë me marrje të masave disiplinore për punonjësit, deri edhe tek ndërprerja e marrëdhënies së punës.

## Neni 19

### Dispozita përfundimtare

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe është e detyrueshme për zbatim nga të gjithë punonjësit e Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Natyra”, Sh.A, Skënderaj.

**Valentina Rama**



**Kryesuese e Bordit të Drejtorëve  
të N.P.L “Eko Natyra” Sh. A**

**Skënderaj**

**Datë: 31.10.2025**